



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 186/1Prot.

Tiranë, më 06 / 02 / 2019

V E N D I M

Nr. 21, Datë 06 / 02 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.128 Regj., datë 29.08.2018, të z.B. B, kundër Drejtorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), me pretendimin për diskriminim për “*shkak të përkatësisë në një grup të veçantë*”¹.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, z.B. B në ankesën e bërë pranë KMD-së ka parashtruar se, që nga viti 2014 e në vijim punon pa shkëputje si zjarrëfikës pranë MZSH Tiranë. Me Vendimin nr.7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë regjistrimi si person juridik i Sindikatës së

¹Referuar Vendimit nr. 7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z.B. B është Kryetar i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe cilësitë e veçanta që i atribuohen qënies së tij si Kryetar i kësaj Sindikate, i ka konsideruar si “përkatësi në një grupim të veçantë”.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (SPMZSH) dhe z.B. B është zgjedhur Kryetar i parë i saj.

Subjekti ankues shprehet se me datë 02.08.2018 është transferuar nga Stacioni nr.5 “Qyteti Studenti” në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”, duke pretenduar se transferimi i tij ka ardhur menjëherë sapo drejtori ka marrë dëgjime për zgjedhjen e tij si kryetar i SPMZSH-së. Ai e ka kundërshtuar këtë transferim verbalisht dhe me shkrim por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e drejtorit. Z.B. B shprehet se ai ka patur performancë të mirë në punë dhe nuk ka marrë asnjë vërejtje, por duke u nisur nga qëllimi i krijimit të SMPZSH-së, për të drejtat e zjarrëfikësve, kushtet e punës etj; ai pretendon se transferimi i tij ka ardhur si pasojë e anëtarësisë së tij në sindikatë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij, ankuesi kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin ndaj tij, nga ana e MZSH dhe rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1181/2 prot., datë 07.09.2018 i është kërkuar informacion MZSH-së, lidhur me pretendimin e z. B. B⁴.

Me shkresën me nr.107prot., datë 06.11.2018⁵ MZSH, ka dërguar një kopje të dokumentacionit të dosjes personale të z.B. B dhe ka informuar Komisionerin se: *“Lëvizja e tij është bërë për arsye organizative për mbarëvajtje më të mirë pune në stacionin e Tunelit Krrabë. Gjatë tre viteve të fundit janë bërë mbi 50 lëvizje midis stacioneve dhe këto lëvizje do të vazhdojnë gjithmonë për arsye të mbarëvajtjes sa më të mirë të punës dhe performancës. Punonjësi në fjalë nuk është larguar nga detyra por është lëvizur brenda shërbimit”.*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së z.B. B, Komisioneri me datë 22.11.2018 realizoi një seancë dëgjimore, ku u kërkuar paraprakisht:
 - Kopje e dosjes personale të z.B. B.
 - Kopje e ankesave të bëra nga ana e punonjësit B. B.
 - Kopje e përgjigjeve të kthyer nga ana e MZSH-së si dhe cilat janë masat e ndërmarra lidhur me këtë problematikë?
 - Kopje të procedurës së mbajtur për transferimin e z.B. B dhe cili ka qenë shkak i transferimit të bërë nga ana e juaj?
 - Informacion nëse janë bërë transferime të zjarrëfikësve të tjerë? Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për – secilin rast, dhe arsyeja e këtyre transferimeve.
 - Informacion për performancën e z.B. B në punë. (kopje të akteve)

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues dhe drejtorit të MZSH-së, z.Sh.G. Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e ankuesit u theksua fakti se ai e kishte vënë në dijeni drejtorin e MZSH-së lidhur me qënien e tij si Kryetar i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (SPMZSH), gjë të cilën e faktonte përmes

⁵ Protokolluar tek KMD me nr.1619 prot., datë 16.11.2018.

komunikimit në whatsapp⁶ dhe po ashtu ai citon se një kopje të vendimit të gjykatës lidhur me regjistrimin e kësaj shoqate si person juridik ia kishte dërguar me anë të postës edhe Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, në tagrin e punëdhënësit të tij.

Drejtori i MZSH-së, lidhur me faktin e marrjes dijani të qënies së ankuesit si Kryetar i SPMZSH-së, u shpreh se nuk e kujtonte komunikimin me ankuesin përmes whatsapp-it dhe se transferimi i tij nuk kishte të bente me diskriminimin ndaj tij, pasi ai kishte realizuar mbi 50 lëvizje të tilla 3 vitet e fundit për qëllime të mbarëvajtjes dhe organizimit së punës dhe kjo gjë ishte brenda kompetencave që ligji i njeh atij.

3. Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, nëpërmjet shkresës me nr.1181/4 prot., datë 05.12.2018 Komisioneri i është drejtuar Bashkisë së Tiranës dhe MZSH-së lidhur me sqarimin dhe dokumentimin e faktit të marrjes dijani nga ana e tyre për qënien e subjektit ankues si Kryetar i SPMZSH-së. Po ashtu është kërkuar informacion lidhur me procedurën e ndjekur prej tyre lidhur me njohjen e vendimit të gjykatës për regjistrimin e kësaj Sindikate si person juridik.

Me anë të shkresës me nr.47588 prot., datë 26.12.2018 MZSH informon Komisionerin se: *“...Procedura e ndjekur për ankuesin është e njëjtë edhe për 50 persona të tjerë pranë kësaj njësie dhe nuk e vë atë në pozita të pabarabarta. MZSH nuk ka tagër ligjor për të ndjekur procedura për njohje të aktit të krijimit të SPMZSH-së sepse është drejtori vendore”*.

Ndërsa, nga ana e Bashkisë së Tiranës nuk u kthye asnjë përgjigje zyrtare, megjithë tejkalimin e afateve ligjore⁷.

4. Në zbatim të Urdhërit nr.15, datë 22.01.2019 të Komisionerit, me datë 29.01.2019, pranë ambjenteve të Bashkisë Tiranë, u realizua inspektimi i cili kishte si objekt të tij⁸ marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë nga përfaqësues të këtij Institucioni, si dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i inspektimit të KMD-së u takua me: Znj.E.O, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Rekrutimit të Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Tiranë.

Gjatë inspektimit u realizua këqyrja e librit të Protokollit të vitit 2018, për periudhën e pretenduar nga ankuesi dhe rezultoi që, në datën 25.07.2018 është protokolluar (me nr.28810 prot.) një shkresë e ardhur nga Sindikata e Punonjësve për Mbrojtjen nga Zjarri⁹, e cila në thelb ishte

⁶Komunikimi në rrjetin social whatsapp daton me 21 Korrik 2018.

⁷Referuar parashikimit ligjor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Administrative.

⁸A është protokolluar pranë Bashkisë Tiranë, me datë 24.07.2018 ndonjë shkresë ardhur nga Sindikata e Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin/SMPZH? Nëse po, një kopje e shkresës.

Cila është procedura e ndjekur nga ana e institucionit të Bashkisë Tiranë, lidhur me njohjen e kësaj Sindikate? A i është përcjellë për njohje Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH) akti i krijimit të SMPZH-së?

⁹ Kopje e fletës ndodhet e depozituar në dosjen e subjektit ankues, në cilësi prove. Fleta nis me nr.rendor 28813 dhe mbaron me nr.rendor 28818.

“Kërkesë për takim me Kryetarin e Bashkisë”. Znj. E.O sqaroi se duke qenë se në objekt të shkresës ishte kërkesa për takim me Kryetarin e Bashkisë dhe jo kërkesa për njohje të vendimit të gjykatës apo njoftimi për krijimin e kësaj sindikate, siç pretendohet nga ankuesi, kjo shkresë nuk i është dërguar për dijeni (apo njohje) asnjë organi apo institucioni tjetër, në varësi të Bashkisë Tiranë, për rrjedhojë as Drejtorisë së MZSH-së. Në këto kushte Drejtori, z.Sh. G, nuk kishte dijeni për këtë fakt.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë sa i takon transferimit të tij.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, me Urdhërin nr.50, datë 13.02.2014 të Prefektit të Tiranës, subjekti ankues, z.B. B është emëruar në detyrën “Shofer zjarrëfikës” pranë PMNZSH-së. Me Urdhërin nr.32985, datë 12.09.2017 të Drejtorit të MZSH-së, është emëruar Personel drejtimi automjetesh në Stacionin nr.5 “Qyteti Studenti”, në Drejtorinë e MZSH-së. Me Urdhërin 1122, datë 23.10.2017 z.B. B është graduar me gradën “Asistent Zjarrfikës”.

Me Vendimin nr.7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë regjistrimi si person juridik i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (SPMZSH) dhe z.B. B është zgjedhur Kryetar i parë e saj.

Me shkresën me nr.29245 prot., datë 27.07.2018 të Drejtorit të MZSH-së, z.B. B është transferuar nga Stacioni nr.5 “Qyteti Studenti” në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”.

Bazuar në deklaratimet dhe dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së nga ana e Drejtorit të MZSH-së, rezulton e provuar se, gjatë tre viteve të fundit janë bërë mbi 50 lëvizje midis stacioneve, duke lëvizuar punonjësit brenda shërbimit, për arsye të mbarëvajtjes së punës në stacionet respektive.

Në vështrim të parë (a prima facie) duket se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pabarabartë krahasuar me punonjësit e tjerë që janë transferuar nga një stacion në një tjetër, me të njëjtin argumentim, atë të mbarëvajtjes së punës në MZSH. Nga ana e Drejtorit të MZSH-së është ndjekur e njëjta procedurë transferimi për të gjithë punonjësit.

Ligji nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës dhe vazhdimsinë në detyrë të punonjësve të këtij shërbimi.

Bazuar në nenin 15 të këtij ligji, është kompetencë e Drejtorit të MZSH-së për emëruar, liruar dhe përjashtuar punonjësit e nivelit bazë të shërbimit vendor të MZSH-së, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj.

Mirëpo, nisur nga fakti që subjekti ankues është Kryetar i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (SPMZSH) që prej datës 10.07.2018¹⁰, legjislacioni në fuqi i siguron atij, pikërisht në tagrin e kryetarit të Sindikatës, disa garanci plus krahasuar me punonjësit e tjerë që nuk gëzojnë këtë status.

Kështu, neni 181 i Kodit të Punës, në pikën 5 të tij ka parashikuar shprehimisht se: “Ndryshimi i kushteve të kontratës së punës të përfaqësuesve të organizatës sindikale mund të bëhet vetëm me pëlqimin e punëmarrësit dhe të kësaj organizate. Punëdhënësi nuk mund të ndryshojë vendin e punës së përfaqësuesve të organizatës sindikale, edhe nëse ky ndryshim është parashikuar nga kontrata e punës, pa pëlqimin e punëmarrësit dhe të kësaj organizate, me përjashtim të rasteve kur ndryshimi është i domosdoshëm për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjes”.

Në pikën 7 të këtij neni është përcaktuar që: *“Punëdhënësi duhet të krijojë kushte dhe lehtësitë e nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave sindikale për ushtrimin normalisht të funksioneve të tyre, të cilat përcaktohen në kontratën kolektive të punës”.*

Neni 186, pika 1, germa c) e tij parashikon se konsiderohen si veprime ndërhyrjeje nga ana e punëdhënësit, masat që dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikaliste, duke e diskriminuar atë.

Në këtë kontekst, është e qartë se z.B. B në tagrin e Kryetarit të Sindikatës i është shkelur e drejta e tij për të mos u transferuar pa pëlqimin dhe dijeninë e tij, duke çenuar kështu të drejtat dhe funksionin e tij si sindikalist. Zona në Stacionin nr.6, “Tuneli Krrabë”, ku ndodhet aktualisht z.B. B, nuk mbulohet me valë nga kompanitë telefonike dhe atij në funksion të realizimit të detyrës së tij si Kryetar i Sindikatës, përveç detyrës funksionale të punonjësit të MZSH-së (asistent zjarrfikës) i duhet të jetë vazhdimisht në komunikim me çdo anëtar të sindikatës për çdo problem që ata mund të kenë (qoftë edhe hipotetiki). Fakti që kjo zonë nuk mbulohet me valë nga kompanitë telefonike nuk u kundërshtua nga z.Sh. G.

Pra, subjekti ankues, duket se është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e Drejtorit të MZSH-së, sa i takon transferimit të tij nga Stacioni “Qytetit Studenti” në Stacionin “Tuneli Krrabë”, në raport me parashikimet ligjore që duhet t’i siguronin një mbrojtje efektive sa i takon qënies së tij si Kryetar i Sindikatës.

Por, Komisioneri vlerëson se në këto rrethana, është e rëndësishme të sqarohet një element kryesor sa i takon momentit të marrjes dijeni të Drejtorit të MZSH-së lidhur me faktin që ankuesi

¹⁰Referuar Vendimit nr.7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ishte zgjedhur Kryetar i Sindikatës dhe momentit të transferimit të tij, gjë që do të argumentohet në vijim të vendimit të KMD-së.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹¹te ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”.Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se megjithëse subjekti ankueska cilësuar “çdo shkak tjetër” si shkak të pretenduar të sjelljes diskriminuese ndaj tij, në kontekst të parashikimeve të nenit 1, të LMD-së, aimbart shkakun e “*përkatësisë në një grup të veçantë*”. Referuar Vendimit nr.7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z.B. B është Kryetar i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe cilësitë e veçanta i atribuohen qënies së tij si Kryetar i kësaj Sindikate, pra si pjesë e grupimit të punonjësve të MZSH-së, njëherësh dhe përfaqësues i tyre. Parë në këtë kontekst, ankuesi ka provuar dhe dokumentuar se bart shkakun e “*përkatësisë në një grup të veçantë*”.

“*Përkatësia në një grup të veçantë*” është shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

¹¹Neni 2: “*Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.*”

Gjithashtu Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9 të tij “Ndalimi i diskriminimit” parashikon “përkatësinë në organizata sindikale” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e MZSH-së, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga ankuesi, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹² dhe trajtimit të pafavorshëm të tij.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, në nenin 50 sanksionon se: *“Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.”*

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³ është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, Ndalimi i diskriminimit, përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Protokolli 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu është më i madh në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Neni 11 i KEDNJ-së garanton të drejtën e e themelimit të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të punonjësve.

¹²Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, *“...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

¹³Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

Në të njëjtën linjë me parashikimet e KEDNJ-së janë edhe parashikimet ligjore që bën Kodi i Punës në nenin 181, pikat 3, dhe 5, të tij, ku specifikohet se: “ *Ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të sindikatës. ...punëdhënësi nuk mund të ndryshojë vendin e punës së përfaqësuesve të organizatës së punëmarrësve, edhe nëse ky ndryshim është parashikuar nga kontrata e punës, pa pëlqimin e punëmarrësit dhe të kësaj organizate...* ”. Në një linjë me nenin 186, pika 1/c) , të Kodit të Punës, i cili i konsideron si veprime ndërhyrjeje të punëdhënësit, masat që: “... *dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë* ”.

Të gjitha këto garanci ligjore në favor të Kryetarit të Sindikatës, referuar z.B. B në rastin konkret, duhet të ishin marrë në konsideratë, në respektim dhe në zbatim të legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar.

Komisioneri, ka shqyrtuar gjithë procedurën e ndjekur sa i takon transferimit të ankuesit dhe marrjen dijeni të qënies së tij si Kryetar i Sindikatës nga ana e Drejtorit të MZSH-së, duke konkluduar se:

- Rezulton se me Vendimin nr.7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z.B. B është zgjedhur Kryetar i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” (SPMZSH).
- Rezulton e provuar se me date 25.07.2018 është protokolluar (me nr.28810 prot) pranë Bashkisë Tiranë një kërkesë për takim me kryetarin e saj nga ana e SPMZSH-së dhe jo ndonjë shkresë për njohje vendimi të gjykatës lidhur me krijimin e Sindikatës. Bashkia Tiranë nuk i ka dërguar asnjë shkresë apo kopje të këtij vendimi Drejtorit të MZSH-së, pra MZSH nuk kishte asnjë dijeni për krijimin e kësaj sindikate dhe për zgjedhjen e ankuesit si Kryetar i saj.
- Deklarimet e ankuesit se e ka njoftuar përmes sms-ve që në datën 21 Korrik 2018 Drejtorin e MZSH-së lidhur me krijimin e Sindikatës dhe zgjedhjen e tij si Kryetar i saj, nuk mund të merren në konsideratë në kontekst të provave për efekt të procesit administrativ.
- Me shkresën me nr.29245 prot., datë 27.07.2018 të Drejtorit të MZSH-së, z.B. B është transferuar nga Stacioni nr.5 “Qyteti Studenti” në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”.
- Me shkresën me nr.1 prot., datë 15.08.2018 subjekti ankues i është drejtuar Drejtorit të MZSH-së, në tagrin e Kryetarit të Sindikatës (SPMZSH), duke i kërkuar informacion për arsyen e transferimit të tij, si dhe duke cituar parashikimet ligjore të Kodit të Punës, bazuar tek të cilat ai nuk mund ta bënte këtë transferim. Referuar kuponit postar provohet se MZSH ka marrë dijeni po në këtë datë.
- Me shkresën me nr.31133/1 prot., datë 14.09.2018 MZSH i është përgjigjur ankuesit se transferimi i tij është bërë për arsye të mbarëvajtjes së punës.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve sipërcituar dhe dokumentacionit të administruar, lidhur me faktimin e momentit të marrjes dijeni nga ana e Drejtorit të MZSH-së për krijimin e Sindikatës dhe zgjedhjes së ankuesit si Kryetar i saj, Komisioneri vlerëson se, transferimi i subjektit ankues ka ndodhur në kushtet kur MZSH-ja nuk kishte asnjë dijeni për faktin e pretenduar nga ankuesi. Mirëpo, me anë të shkresës së datës 15.08.2018 MZSH ka marrë dijeni për qënien e subjektit ankues si Kryetar i Sindikatës.

Komisioneri thekson gjithashtu se, duke qenë se gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, MZSH-ja tashmë është vënë në dijeni të faktit të krijimit dhe funksionimit të Sindikatës (SPMZSH) dhe zgjedhjes së z.B. B si Kryetar i saj, duhet të kishte marrë masat për zbatimin efektiv të gjithë garancive dhe lehtësirave ligjore që legjislacioni në fuqi ka parashikuar për përfaqësuesit e sindikatave. Mosmarrja e masave konkrete për rregullimin e situatës në favor të subjektit ankues nga ana e MZSH-së edhe pas marrjes dijeni të faktit të krijimit të Sindikatës dhe qënies së ankuesit si Kryetar i saj, pas datës 15.08.2018 e deri aktualisht, krijon dyshimin e arsyeshëm se ai është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë, pikërisht për shkak të përkatësisë së tij nësindikatë. Konsiderojmë se, qëndrimi i ankuesit, në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”, në një zonë më të largët vështirëson shumë ushtrimin e funksionit të Kryetarit të Sindikatës. Duke pasur parasysh edhe që zona nuk mbulohet efektivisht me valë nga kompanitë telefonike.

Në nenin 3/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Neni 12, pika 1, germa ç) e tij ka përcaktuar se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji që, ndër të tjera, ka lidhje me: “...anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfutuar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi”.*

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri konstaton se MZSH-ja është në shkelje të parashikimeve të LMD-së, pasi me mosveprimin e saj, edhe pas marrjes dijeni të faktit të qënies së subjektit ankues në cilësinë e Kryetarit të Sindikatës, nuk ka ndërmarrë asnjë masë për transferimin e ankuesit në

vendin e mëparshëm të punës dhe as ka shprehur vullnet për ta marrë në konsideratë një fakt të tillë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, pika 1, germa ç), nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të z.B. B, nga ana e Drejtorit të MZSH-së, për shkak të përkatësisë së tij në një grup të veçantë.
2. Referuar pikës pikës 1, të vendimit, MZSH-ja, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj subjektit ankues, z.B. B, të bëjë rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, MZSH-ja, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Përkatësia në një grupim të veçantë

Fusha: Punësim